

VENDIM
Nr. 436, datë 22.5.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES DHE ZBATUES TË PROJEKTIT TË
BULEVARDIT VERIOR DHE TË REHABILITIMIT TË LUMIT TË TIRANËS TË
FINANCUAR NGA FONDI PËR ZHVILLIM ABU DHABI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të aktit normativ nr. 3, datë 3.5.2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi, për financimin e projektit të bulevardit verior dhe të rehabilitimit të lumit të Tiranës”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të përcaktojë si autoritet kontraktues dhe zbatues të kësaj marrëveshjeje huaje Bashkinë e Tiranës, në cilësinë e agjencisë zbatuese të projektit.
2. Shuma prej 240 000 000 (dyqind e dyzet milionë) dirhamësh të Emirateve të Bashkuara Arabe t’i kalojë përfituesit, Bashkisë së Tiranës, për të financuar zbatimin e projektit.
3. Kryetarit të Bashkisë së Tiranës i delegohet përgjegjësia për menaxhimin e projektit, nënshkrimin e të gjitha kontratave për punë, mallra, shërbime, për zbatimin e projektit, si dhe për përcaktimin e strukturës përgjegjëse për menaxhimin financiar e teknik, për bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve për zbatimin e projektit.
4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha